328/19
13.08.2019

PSH.nr. 328/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042,i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje: z. Nuhi Paçarizi – Kryetar, Blerim Dina - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: "Murseli" shpk & Konstruktori Ing 1996"shpk – Kaçanik,kundër njoftimit për anulim teaktivitetitte prokurimit me titullprokurimit:"Ndërtimi i Urës ne rrugën R-115 (Doganaj – Brezovice)", me numër të prokurimit: 205-19-1430-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –"Ministria e Infrastrukturës,më datën 24.07.2019 mori këtë:

V E N D I M

I.APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: "Murseli" shpk & Konstruktori Ing 1996"shpk – Kaçanik, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull:"Ndërtimi i Urës ne rrugën R-115 (Doganaj – Brezovice)", me numër të prokurimit: 205-19-1430-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –"Ministria e Infrastrukturës.

II.ANULOHET, njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull"Ndërtimi i Urës ne rrugën R-115 (Doganaj – Brezovice)", me numër të prokurimit: 205-19-1430-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –Ministria e Infrastrukturës, dhe lënda kthehet ne **rivlerësim.**

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV.Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V.Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik "Murseli" shpk & Konstruktori Ing 1996"shpk – Kaçanik, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Data e njoftimit për kontratë : 22.03.2019
Data e hapjes se ofertave: 02.05.2019
Data e njoftimit me letrën standarde për tenderues të eliminuar: 06.06.2019
Data e kërkesës për rishqyrtim: 07.06.2019
Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim: 11.06.2019

Operatori ekonomik ankues "Murseli" shpk & Konstruktori Ing 1996"shpk – Kaçanik,si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me20.06.2019me nr. 328/19,kundër njoftimitpër anulim te aktivitet teprokurimit me titull"Ndërtimi i Urës ne rrugën R-115 (Doganaj – Brezovice)", me numër të prokurimit: 205-19-1430-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –"Ministria e Infrastrukturësduke pretenduar se janë shkelur dispozitat.

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin59 dhe 62të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 25.06.2019ka autorizuar ekspertin shqyrtues tëprokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtues në raportin e dt: 04.07.2019, lidhur me pretendimin ankimore te OE ankues Murseli" shpk & Konstruktori Ing 1996"shpk – Kaçanik,në finalizim te analizimit dhe shqyrtimit te këtij aktiviteti

te prokurimit ka sqaruar si në vijim:

Autoriteti Kontraktues – Ministria e Infrastrukturës (MI) , gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës është punë me vlerë të madhe. Pretendimet kryesore ankimore të parashtruesit të ankesës kanë të bëjnë kundër propozimit për anulim te aktivitetit te prokurimit, përkatësisht kundër arsyetimit të eliminimit, ku AK në letër standarde të datës 05.06.2019, ku tekstualisht është potencuar:

A) *Ne DT dhe njoftim për kontrate tek kërkesat mbi mundësit teknike dhe profesionale është kërkuar lista e kontratave te realizuara përfunduara ne lëmin e kërkuar për periudhën e shkuar tre vjeçare jo me pak se 1.000.000,00€. OE duhet te ketë projekte te realizuara ne lëmin e asfaltimit, ndërtimit, rehabilitimit, ri konstruktimit të rrugëve e cila duhet te dëshmohet me procesverbalet e pranimit përfundimtar te punëve duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e projekteve ne lëmin e kërkuar ne periudhën e shkuar tre vjeçare, ndërsa OE ka prezantuar kontrata te realizuara vlerën ceke;*

B) *OE duhet te ofroj se bashku me oferte planin për menaxhimin e trafikut sa me te detajuar duke përfshire përshkrimin dhe skicat e rrugës e cila do te realizohet, EO nuk ka prezantuar skicat për menaxhimin e trafikut".*

Pretendimet ankimore ndërlidhen me kërkesat kapacitetit teknik dhe profesional, konkretisht me pozicionin 6, ku është kërkuar "*Lista e kontratave te realizuara përfunduara ne lëmine e kërkuar për periudhën e shkuar tre vjeçare jo më pak se 1,000,000.00 euro. Operatori ekonomik duhet të ketë projekte të realizuara në lëmin e asfaltimit, ndërtimit, rehabilitimit, rikonstruktimit të rrugëve*". Për te njëjtën kërkese si dëshmi dokumentare është kërkuar: "*Procesverbalet e pranimit përfundimtar të punëve duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e projekteve ne lëmine e kërkuar për periudhën e shkuar tre vjeçare*" si dhe kërkesën e pozicionit 11, "*OE duhet te ofroj se bashku me oferte planin për menaxhimin e trafikut sa më të detajuar duke përfshira përshkrimin dhe skicat e rrugës e cila do te realizohet*". Për te njëjtën kërkese si dëshmi dokumentare është kërkuar: "*Origjinali i planit të menaxhimit të trafikut i nënshkruar nga inxhinieri i komunikacionit dhe vulosur nga kompania*".

Pas administrimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit të prezantuar ne oferte kundrejt pretendimeve ankimore, rezulton qe parashtruesi i ankesës ka prezantuar dëshmi "Referenca", për projekte të realizuara ne periudhën e shkuar dhe te kërkuar nga AK- MI, ku përmes tyre mbulohet vlera e kërkuar, prej 1,000,000.00 €. Po ashtu është prezantuar edhe plani i menaxhimit te trafikut, i detajuar ku përheq tjerash potencohet se menaxhimi i komunikacionit do te behet sipas rregullave dhe ligjeve ne fuqi për

qarkullim rrugor ne Republikën e Kosovës. Për me tepër AK/ MI, përmes dosjes se tenderit, (Aneksi 1, pika 5), përheq tjerash ka potencuar se, *"Kontraktoi është përgjegjës për rregullimin e qarkullimit të komunikacionit në të gjitha rrugët publike të cilat mund të jenë në funksion gjatë zhvillimit të punëve ndërtimore. Kjo pjesë paraqet kërkesat specifike të Projektit për kontroll të komunikacionit rrugor përmes vend punishtes, gjë që duhet të bëhet nga Kontraktoi...".*

Prandaj sipas asaj qe u përshkrua me larte rezulton qe parashtruesi i ankesës ka prezantuar dëshmi kundrejt arsyetimit te eliminimit, rrjedhimisht propozimi ynë është qe AK, përmes rivlerësimit të ofertave mund te aplikoj depozitat e nenit 59, përkatësisht 72, te LPP-se, dhe te kërkoi sqarime shtese për raportet e pranimet teknike te punëve (referenca epet pas pranimit teknik te punëve).

Autoriteti Kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës: 05.07.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues senuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik përmes parashtresës me shkrim të datës: 05.07.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Ne seancën dëgjimore te mbajtur me datën 24.07.2019, ku kane qene te pranishëm, paneli shqyrtues, përfaqësuesi i operatorit ekonomik ankues dhe eksperti shqyrtues, ndërsa përfaqësuesit e AK-se edhe pse ishin ftuar ne mënyrë te rregullt nga OSHP mirëpo këta nuk kane marr pjese ne ketë seance dhe as nuk kane kërkuar qe seanca te shtyhet,ku u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit ne seance përfaqësuesit i operatorit ekonomik ankues deklaroi: Pajtohemi plotësisht me mendimin e ekspertit shqyrtues profesional ne te gjitha pikat dhe jemi te mendimit qe ky aktiviteti i prokurimit duhet te kthehet ne rivlerësim, nuk kemi tjetër te shtojmë pasi qe janë përfshirë te gjitha pretendimet tona ankimore.

Gjatë prezantimit në seancë Eksperti Shqyrtues deklaroj: "Pretendimet ankimore kanë te bëjnë kundër arsyetimit te eliminimit ku janë potencuar 2 pika te eliminimit. E para ka te bëjë me projektet e realizuara dhe tjetra me planin e menaxhimit te trafikut. Pas trajtimit te ankesës ka rezultuar se ankuesi ka prezantuar

dëshmitë përmes te cilave vërtetohet se ka realizuar pune sipas vlerës se kërkuar nga Autoriteti Kontraktues, po ashtu edhe për planin e menaxhimit te trafikut OE Ankues ka prezantuar ne oferte, ku përmes tij zotohet qe menaxhimi i trafikut do te behet sipas ligjeve ne fuqi për qarkullim rrugore prandaj kam propozuar qe lënda te kthehet ne rivlerësim.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se OE ankues pretendimet e tij ankimore i ka, lidhur me arsyet e eliminimit te tij .

Paneli shqyrtues konstaton se operatori ekonomik ankues ka prezantuar referenca ku vërtetohet se ka përfunduar pune ne vlerën e kërkuar sipas autoritetit kontraktues megjithatë i njëjti nuk ka prezantuar në oferte te gjitha raportet pranimit teknik te punëve për te njëjtat referenca, dhe AK mundet konform nenit 59 dhe 72 te LPP-se te kërkoj sqarime shtese.

Paneli shqyrtues konstaton se, Autoriteti kontraktues, përmes dosjes se tenderit ka kërkuar qe operatori ekonomik duhet te ofroj se bashku me oferte planin për menaxhimin e trafikut sa më të detajuar duke përfshira përshkrimin dhe skicat e rrugës e cila do te realizohet. Operatori ekonomik ankues ka ofruar planin e menaxhimit te komunikacionit dhe AK nëse ka dilema mundet konform nenit 59 dhe 72 te LPP-se te kërkoj sqarime shtese.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 dhe nenit 72 të LPP-së.

Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet te ketë në konsideratë nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Po ashtu autoritetet kontraktuese duhet vepruar në harmoni me nenin 6 të LPP-së, ku autoritetet

kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Nuhi Paçarizi

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK –Ministria e Infrastrukturës

1x1 OE- "Murseli" shpk & Konstruktori Ing 1996"shpk – Kaçanik

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.